

## Informacion rreth qytetit

Bashkia e Peqinit kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Elbasan, në juglindje me bashkinë Cërrik, në jug me bashkinë Belsh, në jugperëndim me bashkinë Lushnje dhe në veriperëndim me bashkinë Rrogozhinë.

Bashkia Peqin ka pasur dhe ka një pozitë gjeografike shumë të favorshme.

Ajo ndodhet midis kordinatave gjeografike: 40°58'58" në jug dhe 41°0,9' 33" në veri

Në perëndim: 19°40'0" gjatësi gjeografike, dhe në lindje: 19°54' 34" gjatësi gjeografike.

Sipërfaqja e territorit të bashkisë Peqin është 197.79 km<sup>2</sup>, me popullsi 39.741 banorë dhe dendësia mesatare 200.925 banorë (sipas Regjistrit të Gjendjes Civile, janar 2021).

Në të kaluarën sipërfaqja e qytetit ka qenë më e madhe, por me masat e marra nga shteti gjatë periudhës së komunizmit, këto sipërfaqe i kanë kaluar qyteteve fqinje si Lushnja, Tirana etj.

Nga lindja në perëndim kalon rruga automobilistike dhe ajo hekurudhore

Lartësia e relievit varion nga 20 deri në 610 metra e cila ndodhet në fshatin Cacabezë të njësisë administrative Pajovë.

Në luginën e Shkumbinit ka pisha të buta, të cilat shërbejnë për të ruajtur tokën nga erozioni lumor.

Në territorin e bashkisë Peqin ka gjetje dhe gjurmime të shumë objekteve historike, si: Kalaj, via Egnatia, kulla e sahatit dhe xhamia, sarkofagu, stolid he enë ilire etj.

